Bashkia Kamez
PROTOKOLLI
Nr. 9733 Date 18 / 11 / 24

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**BASHKIA KAMËZ**
**LAGJIA ADMINISTRATIVE BATHORE**

**Nr 1720 Prot** **Bathore, me 18. 11 .2024**

**RELACION**

**"Mbi emertimin e rrugeve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Kamëz"**

Të nderuar këshilltarë,

Duke shprehur mirënjohjen për dëtyrat tuaja funksionale që realizoni pranë këshillit Bashkiak Kamëz, ju paraqesim relacionin mbi emertimin e rrugëve në Lagjen Administrative Bathore, në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr. 9270 datë 29.07.2004 "Për sisemin e adresave "; Vendimit nr.226 prot 27.03.2023 për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të Bashkisë Kamëz si dhe referuar kërkesave me shkrim të banorëve te lagjeve të ndryshme Bathore, të depozituara pranë Lagjes administrative Bathore për emertimin e këtyre e rrugeve.

Në Bazë të verifikimeve në terren nga grupi punes rezulton që firmat korespondojnë konkretisht me kërkesat e parashtruara nga komuniteti i këtyre lagjeve dhe ju propozojmë ju në cilësinë e organit legjislativ të bashkisë Kamëz, marrjen e tyre në shqyrtim për emertimin rrugëve të cituara si më poshtë:

**-Emertimin e rruges, që lidhet me rrugen " Kongresi Dibres " dhe rrugen "Belsh", Lagje nr 7, Bathore, me gjatësi 50 ml, ku propozohet ti vendoset emri "Hoda".**

**-Ne ketë rruge jetojnë dhjetë familje me 50 anëtarë, të cilët jane të gjithe nga fisi Hoda.**

Komisioni i posaçëm ka shqyrtuar dokumentacionin e qytetarëve që kanë dërguar kërkesat me shkrim për emertimet e rrugeve dhe janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore me qellim realizimin e kërkesës së qytetareve

Për sa më lartë :

**PROPOZOJMË**

Miratimin e kërkesave të qytetarëve për emertime të rrugëve , me arsyetimin se nga verifikimet e Komisionit të Posaçëm të grupit të punës rezulton që firmat korespondojnë konkretisht me kërkesat e parashtuara nga komuniteti i këtyre lagjeve dhe kërkesat e tyre përmbushin kriteret ë parashikimeve ligjore në fuqi.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin tuaj,

**Komisioni i Posaçëm:**

-Besim Rama *Firma* ________

-Qemal Meçuku *Firma* ________

-Selman Billa *Firma* ________

**ADMINISTRATOR**

**Afrim DOÇI**

REPUBLIKA E SHQIPERISË - BASHKIA KAMËZ - LAGJJA BATHORE

Data 23.05.2024

- Kërkesë -

Drejtuar Bashkis Kamëz

Bashkia Kamez
PROTOKOLLI
Nr. 4305 Date 24.05.24

Në jemi banorë të lagjes N. 7 Bathore. Rruga Kongresi i Dibrës. Kamëz. Më pa durim po presim të vendoset emri i rrugës në lagjen tonë që lidhet me rrugën Kongresi i dibres dhe rrugen Belsh me gjatësi rreth 200 ml. Gjithashtu në po kërkojmë që emri i rrugës të vendosit Rruga HODA. për arsye se jemi një fis i madh me 9 kryefamiljarë dhe 50 antarë familje po e merrët parasysh juvë. Gjithashtu në po ju kërkojmë që edhe banesave tu vendoset NR. pavarësisht se në i kemi pasur një herë po nuk e dimë [illegible].
Me respekt nga ana e jonë.
Besojm se kerkesa jonë do të merret parasysh.

1 Haxhi Hoda
2 Hysni Hoda
3 Avni Hoda
4 Refik Hoda
5 Xhevit Hoda
6 Naim Hoda
7 Kujtim Hoda
8 Bashkim Hoda
9 Haris Hoda